

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINE E SHËRBIMIT PYJOR SHKODËR**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Shkodër, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2012- deri 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 156 datë 24.11.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 691/7 datë 24.11.2014, dërguar Z. Gjini Brigja, Drejtor i Drejtorisë Së Shërbimit Pyjor, Shkodër, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nuk është hartuar dhe paraqitur në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistri i parashikimit dhe realizimit për prokurimet me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007” *Për Rregullat e Prokurimit Publik*”, Kreu I pika 3/b dhe kreu VI pika 2/a. Në 21 raste në vlerën 2,599,125 lekë të prokurimeve të kryera vlera të vogla, mungojnë kërkesat nga sektorët ose degët që kanë nevojë për mallra, punë apo shërbime, veprime në kundërshtim me UMF nr.92 datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” i ndryshuar me UMF nr.33 datë 11.07.2013. (Trajtuar më hollësisht në faqet 16 - 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga DSHP që në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime të hartohet regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve dhe të paraqiten pranë Agjencisë së Prokurimit Publik. Sektorët përkatës të paraqesin kërkesat e argumentuara për mallra dhe shërbime dhe mbi bazën e tyre të hartohen urdhrat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla.

Menjëherë

2. Në 3 raste në vlerën 607,930 lekë të procedurave të prokurimeve të kryera për blerjet me vlera të vogla, në kërkesën për ofertë në specifikimet teknike është përcaktuar edhe firma e produkteve, gjë e cila e bën të paragykuar procedurën. Në 2 raste në vlerën 149,350 lekë në procedurat e prokurimeve të kryera për blerjet me vlera të vogla, faturat blerjeve janë të nënshkruara nga persona të cilët nuk janë anëtarë të komisionit të blerjeve ose të caktuar. Në 7 raste me vlerë 1008,101 lekë në procedurat e prokurimeve të kryera për blerjet me vlera të vogla faturat e blerjeve nuk janë të firmosura nga anëtarët e komisionit të blerjeve në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 neni 23, pika 5 “Për Prokurimin Publik”. në kundërshtim me VKM nr.1, Kreu VI, pika 1/a, 2/ç “Për rregullat e prokurimit publik”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 16 - 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në lidhje me procedurat e prokurimeve të blerjeve me vlera të vogla DSHP të nxjerrë një akt rregullativ për marrjen e masave me qëllim ndërprerjen e menjëhershme të praktikave të tilla dhe përcaktimin e personave që do të firmosin faturat.

Menjëherë

3. Tërheqja dhe përdorimi i karburantit nga magazina është bërë në mungesë të urdhrave të titullarit, të dokumenteve justifikues (fletë-udhëtimeve). Mungojnë procesverbalet mujore për leximin e kilometrazhit të automjeteve të aparatit në prezencë të drejtuesve të mjetit si edhe procesverbalit të përcaktimit të normës së harxhimit të karburantit për 100 km. Procedura e ndjekur për harxhimin e karburantit është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika 3/a,f dhe udhëzimin nr. 30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes e aktiveve” pika 35/c, 36,38. (Trajtuar më hollësisht në faqet 12 - 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga DSHP që për konsumin e karburantit të përcaktohen normativat e harxhimit të karburantit për 100 km për çdo automjet, për çdo km të përshkruar dhe karburantin e konsumuar nga përdoruesit e mjeteve të hartohen fletë udhëtime, të vendosen limite mujore të harxhimit si dhe nga titullari të nxirren urdhrat e argumentuara për rastet emergjente të daljes së karburantit nga magazina.

Menjëherë

4. Komisioni për kryerjen e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve përbëhet nga 4 persona,dhe jo nga 5 persona si është parashikuar në udhëzim, ky komision nuk ka hartuar relacionin përmbledhës të kriterëve të vlerësimit për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27/12/2011 kreu IV pika 106 “Relacioni i Vlerësimit”, dhe kreu IV pika 100. (Trajtuar më hollësisht në faqet 12 - 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

DSHP të hartojë gjurmën e auditimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ku të përcaktohen fazat që nga ngritja e komisionit, kriteret e vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe hartimin e relacionit përmbledhës deri në miratimin e titullarit.

Në vazhdimësi

5. Në procesin e dhënies së kullotave e livadheve me qera, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Shkodër, nuk është hartuar plani i mbarështrimit të kullotave, plani i veprimit si dhe procedurat e ndjekura në këtë proces, nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të kreut II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008. (Trajtuar më hollësisht në faqet 19 - 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

DSHP të hartojë planin e mbarështrimit të kullotave, të miratojë në Ministrinë e Mjedisit, listën e kullotave të gatshme për dhënie me qira në sezonin përkatës, sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja si dhe të zbatojë procedurat në mënyrë të plotë me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, kreun II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre me qira”.

Menjëherë

6. Në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” si dhe pikën 7, kreun II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008, vendimet e marra nga drejtoria për dhënien me qira

të kullotave, janë pasqyruar në një vendim të vetëm për kërkesat në sezonin veror dhe atë dimëror. (Trajtuar më hollësisht në faqet 19 - 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në zbatim të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" si dhe pikën 7, kreun II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008, DSHP pas administrimit të pasqyrojës në mënyrë të qartë vendimet që do të marrë për dhënien e fondit kullosor me qira, kriteret e përmbushura nga subjekti përfitues, sipas kërkesave të paraqitura për sezonin veror dhe atë dimëror.

Menjëherë

7. Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 10.4.2008, pika 7, kreu III "kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje", nuk ka dokumentuar sondazhet e kryera gjatë periudhës së kullotjes, në lidhje me mos lejimin e futjes së bagëtive mbi kapacitetin kullosor të kontraktuar". (Trajtuar më hollësisht në faqet 19 - 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit, të zbatojë Udhëzimin nr. 4, datë 10.4.2008, pika 7, e kreut III, "kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje", dhe të dokumentojë sondazhet e kryera gjatë periudhës së kullotjes, në lidhje me mos lejimin e futjes së bagëtive mbi kapacitetin kullosor të kontraktuar".

Në vazhdimësi

8. Nuk ka të dhëna për sipërfaqet e prekura nga zjarri, për lëndën drusore të djegur si dhe për dëmin e shkaktuar në fondin pyjor, në kundërshtim me pikën 2/b, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor". (Trajtuar më hollësisht në faqet 27 - 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit duhet të krijojë një databazë në drejtim të sipërfaqeve të prekura nga zjarri çdo vit, të lëndës drusore të djegur si dhe të dëmit të shkaktuar në fondin pyjor.

Menjëherë

9. Gjatë vitit 2012 dhe 2013 nga Seksioni i Menaxhimit të DSHP Shkodër nuk janë ndërmarrë veprime dhe nuk janë ndjekur procedurat e parashikuara në pikën 2/m, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" pasi nuk ka asnjë të dhënë për aktivitetin në pyjet private, përsa i përket nënshkrimit të kontratave ndërmjet pronarit dhe subjekteve të licencuara, etj. (Trajtuar më hollësisht në faqet 27 - 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Seksioni i Administrimit e Menaxhimit të ndërmarrë veprimet e duhura për ndjekjen e procedurave të parashikuara në pikën 2/m, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" përsa i përket informimit në kohë dhe grumbullimit të të dhënave për aktivitetin në pyjet private, përsa i përket nënshkrimit të kontratave ndërmjet pronarit dhe subjekteve të licencuara, etj.

Menjëherë

10. Drejtorja e Shërbimit Pyjor Shkodër nuk disponon evidencë, si dhe të dhënat që përcakton VKM nr. 22, datë 09.01.2008 "Mbi përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të

pyllit komunal”, konkretisht të pikave 7, 8, 9, dhe 14. (Trajtuar më hollësisht në faqet 27 - 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër të hartojë evidenca të sakta, si dhe të krijojë bazën e të dhënave elektronike dhe fizike në lidhje me zbatimin e kërkesave të përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10, 14 të VKM nr. 22, datë 09.01.2008.

Menjëherë

11. Përsa i përket bashkëpunimeve të DSHP Shkodër me institucione të tjera theksojmë se nuk mund të bëhet një vlerësim i saktë në lidhje me efikasitetin real të këtyre bashkëpunimeve, të cilat nuk janë të shoqëruara me plane të përbashkëta pune dhe më tej me arritje të përbashkëta nga procesi i bashkëpunimit, gjë që vë në dyshim zbatimin e tyre në realitet. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Bashkëpunimet e DSHP Shkodër me institucionet e qarkut si Njësitë e Qeverisjes Vendore, Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Policinë e Shtetit, Degën Rajonale të Doganës, të shoqërohen me plane të përbashkëta veprimi dhe më tej me arritje të përbashkëta nga procesi i bashkëpunimit, në mënyrë që të mos mbeten vetëm në letër por të jenë reale dhe rezultateve.

Menjëherë

12. Gjatë hartimit të programit vjetor të punës u vu re që në fushën e sensibilizimit të Komunitetit si dhe në atë të zbatimit të ligjshmërisë e në fushën e organizimit dhe dokumentimit të ngjarjeve pyjore janë vendosur të njëjtët objektiva si gjatë vitit 2012 dhe 2013, gjë që tregon dhe një herë për mosrealizimin e tyre si dhe hartimin e programit pa asnjë ndryshim nga viti në vit. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Hartimi i programit vjetor të punës të kryhet në mënyrë sa më korrekte dhe në përputhje me objektivat dhe problematikat reale të DSHP, si dhe të merren të gjitha masat për realizimin e objektivave të detyrave të përcaktuara në program duke hartuar për këtë një relacion të qartë në lidhje me realizimin e secilës pikë të programit të punës.

Menjëherë

13. Në DSHP nuk rezulton një databazë për të gjitha kundravajtjet administrative e penale, e cila të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të fazës në të cilën ndodhet çdo kundravajtje administrative apo kallëzim penal. (Trajtuar më hollësisht në faqet 38 - 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Seksioni i Policisë Pyjore, tashmë si pjesë e Inspektoratit të Mjedisit duhet të krijojë një databazë të kundravajtjeve administrative e penale, e cila të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të fazës në të cilën ndodhet çdo kundravajtje administrative apo kallëzim penal.

Menjëherë

14. Procedurat e evidentimit dhe ruajtjes së dokumentacionit në arkivë dhe protokoll janë në kundërshtim me nenin 24, të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003, “Për Arkivat”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 5 - 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga DSHP për inventarizimin e dokumentacionit në arkivë dhe rregullimin e procedurave të mbajtjes e dokumentimit e korrespondencës zyrtare të institucionit në arkivë e protokoll.

Menjëherë

B. MAS A ZHDËMTIMI

1. Janë bërë pagesa për 3 drejtuesit e institucionit sipas periudhave përkatëse për shtesë page për vështirësi në kundërshtim me vendimin Nr. 552 datë 11.08.2011 “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të Shërbimit Pyjor”, të ndryshuar, me shumë të përfituar padrejtësisht ***në vlerën 345,000 lekë.*** (Trajtuar më hollësisht në faqet 9 - 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

DSHP të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 345,000 lekë, përfituar padrejtësisht nga drejtuesit e institucionit si shtesë page, për vështirësi të paargumentuar ligjërisht.

C. MAS A DISIPLINORE

Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese, ligjizbatuese, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore nga “Vërejtje“ deri në “Largim nga detyra” në vartësi të përgjegjësisë së konstatuar për:

1. Z. ████████ në cilësinë e Drejtorit të DSHP, Shkodër, për periudhën 01.01.2012 deri më 30.04.2013;
2. Z. ████████ në cilësinë e Drejtorit të DSHP, Shkodër, për periudhën 01.05.2013 deri më 26.11.2013;
3. Z. ████████ në cilësinë e Përgjegjës të Financës për periudhën 01.01.2012 deri më 30.06.2013;
4. Znj. ████████ në cilësinë e Përgjegjës të Financës për periudhën 01.07.2013 deri më 30.11.2013;
5. Znj. ████████ në cilësinë e Përgjegjës së Personelit dhe Arkivë-Protokollit për periudhën 01.01.2012 deri më 30.06.2013.

Trajtuar në procesverbalin 1, 2, 3, të prot., me nr. 1022/1,1022/2, 1022/3, më datë 30.9.2014.

Meqënëse personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune, masën e propozuar e konsiderojmë të ezauruar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mimoza Lloji, Keida Muça, Enida Mata, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i

Drejtoria Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT